



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
ŠTINA GNJILANE - MUNICIPAL GJILAN - GILAN BELEDIYES



Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 19.16 të Rregullores nr. 002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Kryetari i Komunës, nxjerrë:

V E N D I M për

Emërimin e Personit/Grupit Punues për Hartimin e Specifikimeve teknike / Termave të Referencës për aktivitetin e prokurimit: Furnizim me Farë të misrit dhe Pleh Artificial

Caktohet Nazmi Rapuca, ing për bujqësi, për Hartimin e Specifikimeve teknike / Termave të Referencës për aktivitetin e prokurimit: *Furnizim me Farë të misrit dhe Pleh Artificial*

1. Personi/Grupi Punues obligohet që të hartoj Specifikimet Teknike / Termat e Referencës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik.
2. Përgjegjësitë e Personi/Grupit Punues janë që të harton specifikimet teknike/TeR:
 - a) në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, në përputhje me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe legjislacionin dytësor;
 - b) në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik;
 - c) të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhim.